3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: _LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës	
Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve	
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....	
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....	
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike.....	
Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit	
Shtojca 7. Termat e referencës	
Shtojca 8. Formulari i Kritereve te Përzgjedhjes se Ofertuesve	
Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit	
Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....	
Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit.....	
Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit).....	
Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër.....	
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit).....	

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit: Afati i realizimit të mbikqyrjes së punimeve do të jetë 365 (tre qind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Për informacione të detajuara teknike lidhur me objektin e kësaj procedure prokurimi, ju lutem referojuni procedurës së prokurimit të shpallur në www.app.gov.al me të dhënat e mëposhtme:

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Bashkia Sarande
Adresa	Rruga "Abedin Dino", Lagjia nr 1, Sarande
Tel/Fax	0852380/0852380.
E-mail	bashkiasarande@yahoo.com
Faqja e Internetit	bashkiasarande.com
Personi pergjegjes	R.Hazbi
Nr.Kontaktit	08522292
E-mail	R.Hazbi@gmail.com

2. Lloji i procedurës së prokurimit: E Hapur Punet, Prokurim elektronik

3. **Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:** "Furnizimi me uje I zones Baba Rrexhepi dhe lugu I Dardhes.Faza e II (Loti Perfundimtar)."

4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-91236-03-25-2021

5. **Fondi limit** 322 288 648 (treqind e njetete e dy milion e dyqind e tetedhete e tete mije e gjashteqind e dyzete e tete) leke PA T.V.SH

6. **Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 365 dite

7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **30/04/2021** (dd/mm/vvvv)Ora:09:00

Vendi: www.app.gov.al

8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **30/04/2021** (dd/mm/vvvv)Ora:09:00

Vendi: www.app.gov.al

Objektivi kryesor i Mbikqyresit

1.1 Mbikqyresi i punimeve të zbatimit të objektit ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjejë mbarevajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve dhe vlerën e kontratës.

2. Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e Mbikqyresit

-
- 2.1** Ne realizimin e objektivave per zbatimin e punimeve te projektit, Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet:
- Te mbikqyre kontraten e zbatimit te punimeve ne emer te Autoritetit pergjegjes dhe te kryeje te gjitha detyrimet sipas kontrates se nenshkruar dhe legjislacionit ne fuqi.
 - Te njihet ne detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike te objektit, te hartoje programin e kontrollit per zbatimin e projektit dhe cilesise se punimeve, si dhe zbatimit te VNM ne baze te standarteve te percaktuara me ligj (sipas Ligjit Nr. 8402, dt. 10.09.1998, UKM Nr. 3, dt 15.02.2011, UKM Nr. 1, dt.22.02.2005, UKM Nr. 2, date 13.05.2005). Te paraqese prane Autoritetit pergjegjes stafin e tij mbikqyres, siç eshte percaktuar ne kerkesat e stafit kryesor.
 - Ne baze te volumit te punimeve dhe vleres se kontrates Mbikqyresi i punimeve duhet te jete rezident me kohe pune te plote ne objekt, ndersa stafi tjetër mbikqyres mund te jete rezident ne objekt me kohe te pjesshme.
- 2.2** Mbikqyresi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Përgjegjës, duke percaktuar detyrimet e ndersjellta, kushtet e punes, shperblimin, etj.
- 2.3** Mbikqyresi ve ne dijeni Autoritetin Përgjegjës per nenkontraktoret e mundshem qe zgjedh Sipermaresi (Zbatuesi i Punimeve) ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve.
- 2.4** Mbikqyresi ne fillim te punimeve ne objekt, merr kontakt me organet qeverisese, ne juridiksionin e te cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesore pergjegjes per ndertimin e ketij objekti, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi (Neni 9, ligji Nr.8402, dt.10.09.1998).

3. Detyrat e mbikqyresit

3.1 Mbikqyresi ka per detyre:

- Te beje verifikimin e te gjithë dokumentacionit perkates te licensave, te autorizimeve dhe te lejeve, te cilat sipas dispozitave ne fuqi duhet te merren para fillimit te punimeve.
- Te beje verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe gati per te filluar punimet.
- Te njihet me hollesi me kontraten e zbatimit te punimeve dhe te gjithë akteve administrative qe lidhen me te, si dhe njohjen e te gjitha ndryshimeve te mundshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes.
- Te kontrolloje vendosjen e tabelës se identifikimit te objektit me te dhenat e meposhtme:
 - Emertimi i objektit:
 - Data e marrjes se lejes se ndertimit:
 - Investitori:
 - Projektuesi:
 - Sipermarresi dhe drejtuesi teknik:
 - Mbikqyresi:
 - Afati i ndertimit te objektit:
 - Vlera e objektit:

3.2 Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet:

- Te marre masat e duhura per sigurine e objektit duke kontrolluar vendosjen ne objekt te tabelave perkatese sinjalizuese, treguese e te sigurise, shiritave, fenereve, etj.
- Mbas verifikimit te dokumentacionit duhet te dorezoje prane Autoritetit Përgjegjës te gjithë dokumentacionin, si dhe shkresen per fillimin e punimeve ku te perfshihen:
 - Stafi i Sipermarresit
 - Makinerite qe do perdoren per ndertimin e objektit
 - Pikat e marrjes se lendeve te para inerte
 - Zonat e ngritjes se kantjerit

- Para fillimit te punimeve verifikon te gjitha pajisjet dhe makinerite e Sipermaresit, per te pare nese ato i pergjigjen kushteve te kontrates se zbatimit.
- Te kontrolloje zbatimin e projektit duke u bazuar ne projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe te propozoje modifikimet, plotesimet dhe mosperputhjet, nese ka, dhe ti propozoje Autoritetit Përgjegjës zgjidhjet konkrete.
- Te ndjeke ne menyre te vazhdueshme e te kualifikuar te gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve qe duhen te mbahen gjate zbatimit te punimeve, miratimin e analizave te veçanta, duke dhene udhezime, porosi e urdhera per zbatimin me perpikmeri e ne kohe te projektit, te kushteve teknike te projektimit dhe zbatimit te dispozitave perkatese te kontratave.
- Te kontrolloje ne menyre korekte dhe te vazhdueshme piketimin e objektit dhe çdo material qe vendoset ne veper, menyren e vendosjes se tij dhe cilesine e tij.
- Per çdo punim te maskuar te beje (fotografimin ose regjistrim e tij dhe te mbaje proces-verbal te firmosur prej tij dhe sipermaresit.
- Ne çdo fund dite pune te kontrolloje ditarin e punimeve dhe te firmose ate.
- Te kontrolloje librezin e masave, e cila verteton volumin e punimeve dhe ta miratoje ate.
- Te kontrolloje çertifikatat e cilesise se materialeve dhe te jape miratimin per vendosjen e tyre ne objekt.
- Gjate zbatimit te projektit, i jep udhezime me shkrim Sipermaresit, sa here qe e sheh te nevojshme dhe Sipermaresi eshte i detyruar t'i zbatoje ato. Ky i fundit, ka te drejte te beje me shkrim verejtjet e tij lidhur me udhezimet dhe urdherat e marra.
- Per çdo rast, qe gjate zbatimit te punimeve lind nevoja e ndryshimeve ne projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikqyresi i punimeve duhet t'i paraqese Autoritetit Përgjegjës nje relacion te plote teknik, shoqeruar me skicat perkatese ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi ne object, gjate zbatimit te punimeve, do te behet vetem pas miratimit nga Autoriteti Kontra Përgjegjës ktor.
- Ne çdo fund muaji, Mbikqyresi ka per detyre te paraqese prane Autoritetit Përgjegjës raport mujor te punimeve. Ne kete raport duhet te jepet nje tablo e qarte e progresit te punimeve dhe te pagesave te kryera, realizimi i punimeve ne vlere dhe %, afati kohor, realizimi i financimit.
- Korrespondenca ndermjet paleve behet gjithnje ne menyre zyrtare, me shkrim.

3.3 Raporti Mujor do te permbaje lenden e meposhtme:

- Hyrje
- Informacion i pergjithshem
- Te pergjithshme
- Qellimi i punimeve
- Mbikqyrja e punimeve ndertimore
- Personeli i siguruar nga Mbikqyresi
- Stafi i nevojshem ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve
- Stafi aktual
- Koheqendrimi ne objekt per secilin pjesetar te stafit mbikqyres
- Raportimi
- Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes
- Pershkrimi i Projektit
- Karakteristikat teknike dhe te dhena per objektin specifik
- Organizimi i Sipermaresit
- Sipermaresi
- Stafi prezent
- Mjete dhe makineri

- Koheqendrimi ne objekt
- Progresi Mujor
- Pershkrim te Punimeve qe jane kryer gjate muajit (sipas zerave dhe piketave)
- Fotografi te proçeseve te punimeve te kryera
- Fotografi te punimeve te maskuara per çdo punim te padukshem
- Grafiku i ecurise se punimeve
- Te aprovuara
- Te kryera
- Volumet Progressive te Punimeve Mujore
- Punimet e Aprovuara
- Çertifikatat e cilesise dhe Provat Laboratorike²,
- Libreza e Masave
- Punimet e Kryera por te pa aprovuara
- Situacionet mujore
- Matjet topografike
- Korrespondenca
- Proces-Verbale
- Urdhera, Udhezime, Njoftime
- Ndryshime ne Projekt - Preventiv nese ka (te aprovuara nga Autoriteti Përgjegjës)
- Moti (kalendarik)
- Problemet qe kane dale
- Teknike
- Sociale
- Konkluzione

4. Përgjegjesite e Mbikqyresit

4.1 Ne fillim te punimeve Mbikqyresi mban dhe ka përgjegjesi per dokumentacionin e meposhtem:

- Vendimin e sheshit e ndertimit dhe lejen origjinale zhvillimore.
- Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori sebashku me specifikimet teknike.
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik te bazamentit ku do te kryhen punimet.
- Dokumentacionin per realizimin e punimeve te objektit sipas projektit, kushteve teknike te zbatimit ne fuqi dhe specifikimeve teknike.
- Saktesine e vertetesine e dokumenteve, volumet dhe cilesine e punimeve te ndertimit.
- Per realizimin me korrektesi te kontrates se nenshkruar midis Sipermaresit dhe Autoritetit Kontraktor, per realizimin e te gjithë fazave te zbatimit te punimeve, respektimit te afatit te dorezimit si dhe te koston se objektit.
- Asnje punim nuk do te mbulohe, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyresit. Sipermaresi duhet te njoftoje Mbikqyresin kur eshte gati per t'u ekzaminuar prej tij.
- Ruajtjen e te gjithë dokumentacionit dhe korespondencen me Autoritetin Kontraktor, urdherat e ndryshme qe ai ka dhene gjate zbatimit te kontrates, kundershite dhe kontradiktat e lindura gjate punes, nderprerjet e punimeve dhe shkaqet qe i kane diktuar

²Shënim Operatori Ekonomik duhet të paraqese dokumentacion që tregon se disponon apo ka një marrëveshje shërbimi/furnizimi me një laborator të akredituara për testimin e materialeve.

keto nderprerje, relacionet teknike te kerkuara ose te paraqitura gjate zbatimit, si dhe te gjitha rrethanat e nevojshme per te dhene kuadrin e plote te te gjitha fazave te zbatimit te punimeve.

- Ne rast se gjate zbatimit te kontrates kemi ndërrim te Mbikqyresit, per dorezimin e gjithë dokumentacionit qe disponon Mbikqyresi, i gjithë dokumentacioni dorezohet me proces-verbal ku shenohen dhe shkaqet e ketij nderrimi.

5. Te drejtat e Mbikqyresit

5.1 Mbikqyresi ka te drejte:

- Te kerkoje largimin nga puna te Drejtuesit te Kantierit ose te punetoreve te veçante per mosbindje, paaftesi ose pakujdesi te rende.
- Te mos pranoje drejtues teknik, manovrator, punetor, etj, nqs keta nuk plotesojne kushtet per te kryer detyren e caktuar.
- Te pezulloje punimet kur sheh se ne objekt nuk jane marre masat e duhura per te siguruar punimet dhe trafikun.
- Te kerkoje çertifikatat e cilesise se pajisjeve qe kryejne testet e materiale.
- Te kerkoje dhe te asistojë ne kryerjen e provave te materialeve, per te verifikuar cilesine e tyre. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermaresit.
- Te mos lejoje vendosjen ne veper te materialeve qe nuk plotesojne kushtet e cilesise dhe ti zevendesojë ato me materiale te tjera nga Sipermarresi me shpenzimet e tij.
- Te kerkoje per te gjitha makinerite qe punojne ne veper dokumentacionet teknike per te siguruar nje ecuri punimesh te sigurta dhe cilesore.
- Te mos lejoje perdorimin e makinerive dhe pajisjeve te ndryshme nqs ato jane jashte kushteve teknike.
- Ne rast se materialet dhe pajisjet e perdorura nuk miratohen nga Mbikqyresi keto duhet te dokumentohen me proces-verbalet e analizave te provave, se bashku me aktin teknik, ku te argumentohen shmangiet e palejuara referuar standardeve te percaktuara ne specifikimet teknike te projekt-zbatimit.
- Te kerkoje kryerjen e provave shtese per materialet e vendosura ne objekt, kur keto nuk jane kryer ne masen sipas vellimeve te realizuara dhe pjese se lendes se pare te furnizuar per te verifikuar cilesine. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermaresit.
- Kur Mbikqyresi i punimeve mendon se ka demtime ne konstruksion, kerkon te behen verifikimet perkatese. Kur verifikimet i japin te drejte Mbikqyresit, shpenzimet jane ne ngarkim te Sipermaresit. Ne rast te kundert, Sipermaresi ka te drejte te kerkoje shlyerjen e shpenzimeve.
- Mbikqyresi i punimeve urdheron Sipermaresin te prishe dhe te ribeje me shpenzimet e tij, punime te bera jo me cilesine e parashikuar ne projekt dhe specifikimet teknike.
- Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet, per ekzekutim teknik te gabuar ose paaftesi teknike zbatimi, per çdo rast, me miratimin e Autoritetit Përgjegjës per aq kohe sa ai e konsideron te arsyeshme. Ne kete rast, sipas fajit, Mbikqyresi se bashku me Autoritetit Përgjegjës dhe Sipermarresin percaktojnë zgjatjen ose jo te afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
- Te kontrolloje dhe autorizojë perdorimin e fondit rezerve te preventivuar dhe i raporton periodikisht Autoritetit Përgjegjës per gjendjen e tij. Ne rast se Autoriteti Përgjegjës ka verejtje e njofton Sipermarresin dhe problemi zgjidhet midis tyre.
- Per çdo ndryshim te mundshem ne objekt, Mbikqyresi i punimeve ve ne dijeni Autoritetin Përgjegjës.

5.2 Ne perfundim te punimeve Mbikqyresi:

- Merr me shkrim njoftimin per perfundimin e punimeve dhe verteton ne proçes-verbal daten e perfundimit te tyre sipas projektit, te ndryshimeve te urdheruara e te kushteve te kontrates dhe brenda 30 diteve merr prej Përgjegjës it dokumentacionin perkates.
- Sipas legjislacionit ne fuqi dorezon prane Autoritetit Përgjegjës te gjithe dokumentacionin perkates per te cilin mban pergjegjesi te plote ne plotesimin, saktesine dhe vertetesine e tij.

5.3 Ky dokumentacion duhet te permbaje:

- Proçes-verbalin e dorezimit te sheshit te ndertimit
- Proçes-verbalin per fillimin e punimeve
- Kontraten e Siper marrjes
- Kontraten e Mbikqyrjes
- Projekt organizimin e punimeve
- Projektin teknik te zbatimit
- Projektin e ndryshuar (nese ka) shoqeruar me korrespondencen, skicat perkatese dhe miratimet e nevojshme
- Preventivin fitues
- Preventivin e ndryshuar (nese ka zerat te rinj te punimeve, negocimin e tyre)
- Grafikon e punimeve
- Specifikimet teknike
- Azhornimin para fillimit te punimeve dhe piketimi
- Dokumentacionin fotografik apo video regjistruesi per punimet e padukshme
- Proçes-verbalet e çdo punimi te maskuar te firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyresi te shoqeruar me fotografi
- Ditarin e objektit ku te pasqyrohen dhe ndryshimet e urdheruara nga Mbikqyresi
- Librezen e masave
- Shkresen e Mbikqyresit per investitorin ku raporton perdorimin e fondit rezerve, shoqeruar me dokumentacionin perkates
- Proçes-verbalin e perdorimit te fondit rezerve te firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
- Preventivin e fondit rezerve te firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
- Situacionin e fondit rezerve te firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
- Çertifikatat e cilesise se materialeve
- Miratimin e materialeve te perdorura nga Mbikqyresi
- Situacionet pjesore dhe situacioni perfundimtar
- Regjistrin e kontabilitetit
- Deklaraten teknike te Sipermarresit te firmosur nga Sipermarresi dhe drejtuesi teknik
- Njoftimin e sipermarresit per perfundimin e punimeve
- Proçes-verbalin e perfundimit te punimeve te firmosur nga Sipermarresi dhe Mbikqyresi, se bashku me matjet faktike te objektit te ndertuar
- Relacionin perfundimtar te Mbikqyresit

5.4 I gjithe dokumentacioni duhet te kete miratimin e Mbikqyresit. Ky dokumentacion pergatitet e dorezohet ne 3 (tre) kopje.

5.5 Nje kopje e te gjithe dokumentacionit dorezohet prane grupit te kolaudimit qe ngrihet brenda 30 diteve nga perfundimi i objektit. Te gjithe dokumentat qe dorezohen prane grupit te kolaudimit duhet te jene origjinale.

5.6 Mbikqyresi i punimeve merr pjese ne Kolaudimin e objektit dhe i pergjigjet grupit te kolaudimit per te gjithe dokumentacionin e nevojshem gjate kolaudimit te objektit dhe firmos. Pas perfundimit te kolaudimit, Mbikqyresi i punimeve mbeshtetur ne kontraten dhe ne dokumentacionin tjeter, percakton vleren perfundimtare te objektit, e cila i behet e ditur Sipermaresit dhe i jepet per te likuiduar Autoritetit Përgjegjës.

6. Kohezgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes

6.1 Shërbimi i mbikqyrjes zgjat për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve.

6.2 Autoriteti Përgjegjës ka të drejtë të kërkojë largimin e Mbikqyresit kur vertetohet mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara
- Nderprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuar, tolerim të materialeve jashtë cilësive të kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike
- Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Autoriteti Përgjegjës ka të drejtë të urdherojë Mbikqyresin e punimeve për nderprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbejnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të legjislacionit në fuqi.

Objekti i Kontratës: Mbikqyrje e punimeve për objektin: “Furnizimi me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe Lugu i Dardhës, Faza II (Loti përfundimtar) ”

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 3 793 310, 67 (tre milion e shtatë qind e nëntëdhjetë e tre mijë e tre qind e dhjetë presje gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 365 (tre qind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Bashkia Sarandë

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas Shtojcës 8.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të

paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019 dhe 2020 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël sesë 40% e fondit limit të procedurës së prokurimit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3(tre) vitet e fundit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2019 dhe 2020 , të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, bazuar në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, si dhe Ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

2.2.3 Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofrohet për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojnë liçencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçencën profesionale të shoqërisë në projektim, sipas formatit të miratuar

me VKM nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave “Për liçencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, për kategoritë e mëposhtme:

NP-1 Punime gërmimi në tokë

NP-2 Ndertime civile dhe industriale

NP-5 Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti

NP-7a Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

NS-4 Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami, dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese

NS-8 a. Ndërtime parafabrikat beton arme.

NS-8 b. Struktura metalike

NS-9 Punime strukturore speciale

NS-16 Ndërtimi i impijanteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.

NS-18 Punime topogjeodezike

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë të përfshirë në ekipin e tij si pjesë të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e shërbimeve të kontratës, minimalisht këta ekspertë:

Numri	Pozicioni
1 (një)	Inxhinier Ndërtimi
1(një)	Inxhiner Elektrik
1(një)	Inxhinier Hidroteknik
1(një)	Inxhinier Mekanik
1 (një)	Inxhinier/ Ekspert mjedisi
1 (një)	Inxhinier Gjeodet
1 (një)	Inxhinier Gjeolog

Për ekspertët e mësipërm të paraqiten:

-
- Licensat profesionale
 - CV
 - Kontratë individuale pune ose kontratë bashkëpunimi për procedurën e prokurimit në fjalë.

Ekspertët kryesor të paraqitur në tabelën e mësipërme, të gjithë sëbashku sipas profesionit përkatës duhet të zoterojnë në **Licensat profesionale** kategoritë si me poshte:

Mbikqyrës - Inxhinier Ndërtimi:

NP-1 Punime gjurmimi në tokë

NP-2 Ndertime civile dhe industriale

NP-5 Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti

NP-7a Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

NS-4 Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami, dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese

NS-8 a. Ndërtime parafabrikat beton arme.

NS-8 b. Struktura metalike

NS-9 Punime strukturore speciale

Mbikqyrës - Inxhinier Hidroteknik /Mekanik

NP-7a Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

NS-16 Ndërtimi i impijanteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.

Mbikqyrës – Punime të inxhinierisë së mjedisit

NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

Mbikqyrës – Inxhinier Gjeodet

NS-18 Punime topogjeodezike

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 8 (tetë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri:

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të vërtetuar këtë kusht, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.
- Listëpagesat e punonjësve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, për periudhën **Nëntor 2020 –Prill 2021**.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Çertifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ ekuivalent. Çertifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme) /ose/ ekuivalent. Çertifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën **OHSAS 18001**, për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe të sigurisë në punë (e vlefshme)/ ose/ ISO 45001:2018/ose ekuivalent. Çertifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikimet e mësiperme duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer e të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj, të jenë të vlefshme, si dhe duhet të plotësohen nga secili prej anëtarëve në rast të ofertës nga bashkim operatorësh, përveç çertifikimeve të cilat lidhen me procese të veçanta të cilat duhet të plotësohen në përputhje me zërat/proceset e marra përsipër në bashkëpunim

* Të gjitha çertifikatat e mësiperme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Oferta ekonomike duhet të jetë në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”. - Të gjitha ofertat që do të jenë më të ulëta se tarifat minimale të lejuara në bazë të parashikimeve të VKM nr. 354, datë 11.05.2016, do të refuzohen.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
